

# MINISTRIA E ARSIMIT SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË

Departamenti i Arsimit

Divizioni për Vlerësim dhe Standarde

TEMA:

## VLERËSIMI I BRENDSHËM

(VLERËSIMI NË KLASË)

Mustafë Kadriu  
m\_kadriu@yahoo.com

17. prill 2010 Prishtinë

## Çka do të thotë të ndryshosh ?

- Të vlerësosh me objektivitet të kaluarën, arritjet dhe dobësitë;
- Të përcaktosh qartë vizionin e së ardhmes që duhet t'u përgjigjen kërkesave të shoqërisë në të cilën jeton;
- Të jesh i gatshëm të komunikosh me koleg për profesion dhe lëmi të tjera.



## Pse duhet të ndryshosh?

- Ndryshojnë zhvillimet në shoqëri, andaj rrjedhoja e kërkesave të reja nuk mund t'u përgjigjemi me konceptet e praktikave të kaluara.
- Ka ndryshuar pikësynimi i përgjithshëm i shoqërisë

## Çka duhet të ndryshosh ?

- Mardhëniet mësues – nxënës;
- Raporti individ - grup;
- Mënyra e formimit të nxënësit;



## Qëllimi i temës

- **Ngritja e cilësisë në mësimdhënie për mësimnxënie.**



# Objektivat e temës

- Marrja e informacioneve për vlerësim të brendshëm:
  - qëllimet e vlerësimit
  - parimet themelore të vlerësimit
  - funksionin e vlerësimit
  - mënyrën e vlerësimit
  - dokumentet bazë për procesin e vlerësimit
  - mbështetjet bazë gjatë procesit të vlerësimit
  - format e vlerësimit
  - teknikat e vlerësimit
  - ilustrime me shembuj

## □ Çka është vlerësimi ?

- Vlerësimi është proces i mbledhjes sistematike, analizimit dhe interpretimit të informatave me qëllim të përcaktimit se në çfarë shkalle nxënësi i ka zotëruar objektivat udhëzuese.

## Çka është vlerësimi i brendshëm ?

- Vlerësimi i brendshëm është një proces i mbledhjes sistematike, analizimit dhe interpretimit të informatave duke përdor procedurat dhe teknikat e ndryshme të vlerësimit në klasë nga mësimdhënësit dhe nxënësit, të cilët vlerësojnë punën dhe arritjen e rezultateve të tyre në zotërimin e objektivave udhëzuese në klasë.



# ■ Kush e kryen vlerësimin e brendshëm ?

## ■ strukturat e vlerësimit

- mësuesit,
- nxënësit,
- aktivet profesionale,
- këshillat e klasëve

## ■ strukturat drejtuese të shkollës

- drejtori me stafin profesional



## Cilat janë fazat e vlerësimit të brendshëm ?

- Përcaktohen qëllimet e vlerësimit;
- Përzgjedhen llojet dhe modelet e vlerësimit;
- Bëhet planifikimi dhe realizimi i veprimtarisë vlerësuese;
- Mbahen shënime dhe analizohen ato;
- Përgatitet raporti;
- Prezentohen rezultatet e vlerësimit.

- Cili është qëllimi i vlerësimit të brendshëm ?
  - Ngritja e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie
    - shkalla e arritshmërisë e nx. (Testi i arritshmërisë)
    - shkalla e ndërtimit shpirtëror e nx. (Vrojtimi, Vetraportimi)
    - përcaktimi i shkathtësive të domosdoshme (Tes. i gadish.)
    - shkalla e zotërimit të objektivave (Test i gadish, Vetraportimi. Vroj)
    - përcaktimi i përparimit të nx. në mësimnxënie (Testi i zotërimit)

- përmirësimi i mësimnxënies (Testi formativ)

- përcaktimi i shkaqeve të vështirësive (Testi diagnostik)

- notimin e nxënëve (Testi i arritshmërisë, Testi i kombinuar)

- pëshkrimi i manifestimit në ndonjë fushë lëndore (T. zotimit)

- përcaktimi i shkallës së arritshmërisë e një nx. në raport me rezultatin më të mirë në një grup të njohur.

(Testi i bazuar në normë, Testi i përgjithshëm i përpiluar nga mësimëdhënësi).

## Cilat janë vlerat e vlerësimit të brendshëm?

1. Vlerësimi duhet të jetë i vlefshëm — ai duhet të vlerësojë atë që dëshirojmë ta vlerësojmë.
2. Vlerësimi duhet të jetë i besueshëm — që vlerësuesit e ndryshëm dhe në kohë të ndryshme duhet të jetë i qëndrueshëm (pra vlerësimi me të njëjtin standard).
3. Vlerësimi duhet të jetë i barabartë — instrumentet e vlerësimit duhen të jenë të njëjta dhe proceset të jenë të drejta.
4. Vlerësimi duhet të jetë i pa-anshëm — pra nuk duhet favorizuar individin apo grupin.
5. Vlerësimi duhet të bëhet në kohë të duhur.

## Qëllimi i vlerësimit për nxënësit

- Diagnostifikimi i pikëve të forta dhe të dobëta të nxënësve, si bazë për të përcaktuar ecurinë e të mësuarit në të ardhmen;
- Motivimi i nxënësve duke iu dhënë atyre informata që synon të njohë gjendjen dhe nivelin që mund ta arrijnë;
- T'u mundësojë nxënësve përparim që ata të arrijnë t`i zotërojnë objektivat udhëzuese;
- Pasqyrimi i rezultateve që do të shërbejnë si bazë për të përzgjedhur shkollimin e mëtutjeshëm si dhe aftësimi për punësim.

## Qëllimi i vlerësimit për prindërit

- Të sigurojnë informacion, se sa kanë arritur fëmijët e tyre në krahasim me fëmijët tjerë në nivel klase, shkolle;
- Të përcjellin punën e fëmijëve të tyre;
- Të ndërmarrin masa për përparimin e fëmijëve të tyre;

## □ Qëllimi i vlerësimit për mësimdhënës

- Dhënia e informacioneve të nevojshme për arritjet e nxënësve, se në çfarë mase i zotërojnë objektivat udhëzuese të lëndës dhe udhëzime për të ardhmen;
- Krahasimi i rezultateve, të cilat ndihmojnë për t`a përmisuar planifikimin dhe cilësin e mësimdhënies;



## ■ Cilat janë funksionet e vlerësimit të brendshëm?

- për monitorim
- për planifikim
- për përmirësim
- për zhvillimin e veprimtarisë në proces
- për përgjegjësi
- për përzgjedhje
- për certifikim
- për motivim
- për mbështetje publike
- për ushtrim autoriteti etj.

Një vlerësim i vetëm mund të përdoret më tepër se sa një funksion

## □ Parimet themelore të vlerësimit të brendshëm

■ Secili mësimdhënës - vlerësues i brendshëm duhet të respektojë parimet themelore gjatë procesit të vlerësimit;

1. Përcaktimi i qëllimit dhe përparësitë në procesin e vlerësimit;
2. Përshkrimi i kujdeshëm i qëllimit të matjes;
3. Rezultatet e parashikuara të nxënimit;

4. Zgjedhja e matjeve të mundshme

5. Zgjedhja e teknikave të përshtatshme të vlerësimit në përputhje me karakteristikat që duhen të maten:

- Objektive;
- Të sakta;
- Të përshtatshme;

6. Zbatimi i teknikave të ndryshme të vlerësimit

- Vrojtimi: që të vlerësojë shkathtësitë e manifestimit dhe sjelljet e ndryshme të nxënësit;
- Testi objektiv: kur vlerësuesit e ndryshëm që i masin të njëjtat objektiva në mënyrë të pavarur arrijnë rezultate të njëjta të shkallës së arritshmërisë;

- Testi subjektiv: kur vlerësohet në bazë të kriterëve dhe gjykimit të vlerësuesit;
- Testi ese: që t`i masim aftësitë për organizimin dhe shprehjen e ideve;
- Vetëraportimi: vlerësohen shkathtësitë e nxënësit me hulumtime të ndryshme, nxjerrja e përfundimeve dhe raportimi i tyre;
- Portofolio (dosja): përzgjedhja e punimeve më të mira nga vetë nxënësi, por edhe nga mësimdhënësi, nxënësit e klasës apo prindërit
- Pyetësori;

□ Cilat lloje të vlerësimit përdoren më së shumeti në vlerësimin e brendshëm?

■ Vlerësimi diagnostikues:

ka për qëllim që të përcaktojë shkaqet e qëndrueshme të problemeve në mësimnxënie dhe formulimin e planit të veprimit për t`u ndihmuar nxënësve;

■ Vlerësimi formativ:

ka për qëllim të kontrollojë përparimin e nxënies së nxënësve gjatë procesit mësimor, pra kontrollon shkallën e zotërimit të objektivave udhëzuese;

■ Vlerësimi përmbledhës:

ka për qëllim sigurimin e informatave mbi arritjen e objektivave udhëzuese të lëndës në mbarim të nënkategorisë, kategorisë programore, në fund të semestrit apo në fund të vitit, për të vendosur notë;

## □ Si realizohet vlerësimi i brendshëm?

- Është i përditshëm dhe i vazhdueshëm ;
- Me anë të kërkesave që bëhen në klasë;
- Me anë të detyrave të shtëpisë;
- Me anë të aktivizimit në klasë gjatë shtjellimit të materialit;
- Me anë të aktivizimit të punës në grup;
- Testeve kohëshkurtëra – përvetësim i njësisë mësimore;
- Kuize;
- Shoqërohet edhe me vënien e notave, etj.

## □ Në çka duhet pasur kujdes gjatë procesit të vlerësimit të brendshëm ?

- Humbja e përkohshme apo e pjesshme e objektivave të vlerësimit;
- Pamjaftueshmëri e treguesve që përdoret për të bërë vlerësimin;
- Duhet t`i kushtohet sa më shumë përvetësimit të koncepteve;
- Nuk ka rëndësi riprodhimi i vërtetimeve dhe zbatimeve por kuptimi i thelbit të koncepteve si model i punës së pavarur ( një përqindje jo e madhe e kohës së mësimi);

- Momente kur duhet të përdoret teksti shkollor;
- Momente kur duhen të përdoren mjetet e punës;
- Mos të ketë shumë riprodhim gojor të materialit të mësimit;
- Mos të humbet kontakti nxënës – mësues;
- Mosngarkimi tej mase me rregulla e formula;



## □ Vlerësimi i arritjeve sipas rezultateve të pritura:

- Nxënësit demonstrojnë arritjet e tyre në të mësuarit e lëndës, në përputhje me një sërë faktorësh – pra në përputhje me mundësitë psikike dhe emocionale të tyre;
- Rezultatet e pritura zakonisht paraqiten për tri nivele;
  - I. arritja minimale – kufiri i poshtëm i lejueshëm, realizohet me anë të kërkesave standarde në klasë ( 40% - 60%);
  - II. arritje mesatare – karakterizohen rezultatet drejt të cilave synohet që të përvetësohet baza e lëndës së zhvilluar (60% - 80%);
  - III. arritje e lartë – karakterizohet me kreativitet siguri dhe saktësi e zotërimit të objektivave udhëzuese (mbi 80%);

## Shembull:

Tre nivelet e arritjeve për arsyetim, zgjidhje problemore dhe komunikim

### □ Niveli I.

#### ■ Zgjidh probleme :

- me ndihmën e mësimitdhënësit;
- me një kufizim metodash;
- me gabime apo me mangësi.

#### ■ Përdor arsyetim matematikor:

- me ndihmën e mësimitdhënësit;
- me metoda që janë më të thjeshta;
- me gabime apo me mangësi;

#### ■ Komunikon njohuritë:

- me ndihmën e mësimitdhënësit;
- I paqartë dhe i pasaktë;
- duke përdorur rrallë terminologji të përshtatshme;

## □ Niveli II

### ■ Zgjidh probleme me:

- me ndihmë të kufizuar nga mësuesi;
- me një numër jo të madh strategjish bazë;
- me gabime apo me mangësi të pjesëshme;

### ■ Përdor arsyetim matematikor:

- me ndihmë të kufizuar nga mësuesi;
- metoda të përshtatshme për zgjidhje;
- me disa gabime apo me mangësi të vogla;

### ■ Komunikon njohuritë:

- pa ndihmën e mësuesit;
- me një farë qartësie të saktë;
- përdor herë pas herë terminologji të përshtatshme;

## □ Niveli III

### ■ Zgjidh probleme :

- në mënyrë të pavarur;
- me një numër të madh strategjish dhe duke krijuar strategji të reja;
- zakonisht me saktësi.

### ■ Përdor arsyetim matematikor:

- në mënyrë të pavarur;
- të përshtatshëm për zgjidhje, krijon zgjidhje edhe vetë;
- pa gabime apo me mangësi.

### ■ Komunikon njohuritë:

- në mënyrë të pavarur;
- qartë dhe saktë;
- duke përdorur terminologji dhe simbolikë të përshtatshme;

□ Dokumentet bazë gjatë procesit të vlerësimit ?

- Sistemi i vlerësimit duhet të mbështetet në “ Udhëzim administrativ për vlerësimin e shkallës së arritshmërisë së nxënësve” i lëshuar nga MASHT;
- Sistemi i vlerësimit duhet të mbështetet në udhëzimet që janë të dhëna në “Plani dhe programi mësimor” për lëndë dhe klasë përkatëse;

- Sistemi i vlerësimit duhet të mbështetet mbi një sasi të mjaftueshme të dhënash:

- vlerësimi me notë për përgjigje;
- vlerësimi i aktivizimit në vend;
- vlerësimi i aktivizimit të punës në grupe;
- vlerësimi me teste afatshkurtëra;
- vlerësimi në fund të nënkategorisë programore;
- vlerësimi në fund të kategorisë programore;
- vlerësimi në një periudhë kohore;
- vlerësimi në gjysmëvjetor;
- vlerësimi në fund të vitit mësimor, etj;

## □ Vlerësimi me notë:

- Problemi kryesor ka qenë dhe në një të ardhme të afërt do të jetë, vendosja e notës sepse është një gjykim mbi statusin dhe përparimin e nxënësit, në intervale të ndryshme kohore;
- Nota është paraqitja e rezultateve të arritjeve dhe përparimeve akademike të nxënësit;
- Nota ka për qëllim dëshminë e arritjeve të nxënësit , për orientim vetjak të tij, informim të prindërve mbi të arriturat e fëmijëve të tyre dhe është orientim i profilizimit;
- Nota vendoset si rezultat i të arriturave e jo edhe i sjelljeve disiplinore;

## Nxjerrja e notës përfundimtare:

- Nota përfundimtare nxirret si rezultat i të gjitha të arriturave akademike që i arrin nxënësi me të gjitha format e vlerësimit dhe instrumenteve matëse si;
  - vlerësimi me gojë (... %);
  - vlerësimi me teste (... %);
  - vlerësimi i punës në klasë (... %);
  - vlerësimi i detyrave të shtëpisë (... %) , etj.



## □ Teknikat dhe instrumentet e matjes gjatë vlerësimit:

Jo gjithmonë, vlerësimi me teste gjatë gjithë vitit ;

### ■ Vrojtimi i drejtpërdrejtë – si teknikë e përdorshme në të gjitha nivelet e shkollimit që përdoret për të vlerësuar aktivizimin nga vendi dhe ndihmesën e punës në grupe;

- siguron kontroll për përparim të përditshëm;
- siguron të dhëna pa e cenuar kohën e orës mësimore;
- vështirë planifikohet;
- ka besueshmëri të diskutueshme;
- nuk shmang plotësisht të gjykuarit subjektiv;

## □ Buletini i pjesëmarrjes:

- Përdoret si instrument gjatë vrojtimit dhe ndihmesës së punës në grupe të vogla;
- Planifikohet për një periudhë të gjatë kohore (semestral, apo vjetore);

Përdoret kjo tabelë e të dhënave:

Nr.	Nxënësi	Tipi i ndihmesës			
		a.sh.lartë	a.lartë	a.kënaq	a. kufiz
1.	F. F.	5	3	0	4
2.	X. Y.	2	4	1	5

- Në bazë të këtij buletini caktohet një shkallë e vlerësimit dhe mund të vendoset një notë që gjendet me anë të kësaj formule:

$$n_g = \left[ \frac{x_1 \cdot 5 + x_2 \cdot 4 + x_3 \cdot 3 + x_4 \cdot 2}{x_1 + x_2 + x_3 + x_4} \right]$$

$$n_g = \left[ \frac{5 \cdot 5 + 3 \cdot 4 + 0 \cdot 3 + 4 \cdot 2}{5 + 3 + 0 + 4} \right] = 3.75$$

ku  $x_1$ ,  $x_2$ ,  $x_4$ , janë dendëria e ndihmesave që vërehen gjatë një periudhe kohore, kuptohet se  $x_1$  është denduria e ndihmesës “arritje shumë e lartë”, po ashtu  $x_2$  është denduria e ndihmesës “arritje e lartë” etj.

## □ Listë kontrolluese:

- Është instrument që përmban një listë konceptesh, shkathtësi, shprehje dhe vlera, për të vrojtuar dhe për të matur aktivizimin e nxënësve gjatë punës së pavarur nga vendi në klasë, laborator apo në punishte;
- është instrument që dëshmon përvetësimin e shkathtësive shprehive dhe vlerave, për një njësi nënkategori, kategori të përmbajtjes programore, ushtrim laboratorik, ushtrim praktik etj.
- për secilin nxënës sa herë që vrojtohen një element nga lista shënohet me ndonjë shenjë p.sh. a,b,c,d, apo: +, -, \*, 0,
- nëse e shprehim në nota atëherë ato i shoqërojmë duke i shprehur me %, për shkallën e arritshmërisë;

# LISTË KONTROLLUESE

Klasa : IX – të

Nxënësi: X . Y.

Lënda : Matematikë

Njësia mësimore: Grafiku i funksionit linear

Njohuritë, shkathtësitë dhe vlerat, me peshat përkatëse:

1. Përkufizimi i funksionit linear  
(10%)
2. Ndërimi i grafikut të funksionit linear i dhënë me tabelë  
(10%)
3. Ndërimi i grafikut të funksionit linear i dhënë me formulë  
(15%)

4. Gjetja e funksionit linear nëse është dhënë grafiku i tij (20%)
5. Gjetja e bashkësisë së vlerave të funksionit kur dihet grafiku i tij (20%)
6. Të diskutohet grafiku i funksionit  $y = ax+b$ ; (rritja, zvogëlimi, zerot, ... ) për vlera të caktuara të  $a$  dhe  $b$ . (25%)

Nr.	Nxënësi				
		a	b	c	d
1.	F. F.	+	*	0	-
2.	X. Y.	-	+	*	0
...					

## Vlerësimi i nxënësve në tabelë:

Duhet pasur parasysh disa kërkesa;

1. Çështja që do të pyetet duhet të jetë e ndryshme nga ajo që nxënësit janë duke punuar në klasë
2. Kërkohej që të mos harxhohet shumë ( 8-10 minuta)
3. Të paraqes interes për klasën, dëgjimi i përgjigjes
4. Të ketë kontrollera të ndryshme, elemente të materialit të ri, në trajtë të punës krijuese
5. Vlerësimi bëhet duke u përgjigjur gojarisht, nga tabela, duke shkruar në tabelë, apo duke vazhduar punën edhe në vend
6. Vlerësimi bëhet në të gjykuarit e vet mësime dhënësit mbështetur në rezultatet e pritura ( objektivat e përgjithshme dhe specifike)



□ Vlerësimi i shkathtësive laboratorike apo puna praktike:

- Element i rëndësishëm në zhvillimin e procesit të mësimdhënies në shumë lëndë janë veprimtaria laboratorike, praktike dhe eksperimentëve
- E rëndësishme të shfrytëzohen mundësitë reale dhe praktike që lejon mjedisi i të nxënit
- Shumë veprimtari të disa lëndëve realizohen me anë të përvojave praktike, prandaj theksi vihet mbi vrojtimet e lidhjeve shkak-efekt-dukuri

## Veprimtaria praktike realizohet nëpërmjet :

- strategjisë së të nxënit;
- zhvillimit të shkathtësisë;
- zbatimit;
- shpjegimit të dukurive;

Në procesin e planifikimit të punës praktike është e rëndësishme procedura e vlerësimit:

- Tabela e vlerësimit – në të cilën paraqiten çdo nxënës dhe çdo veprimtari që e sheh progresin e nxënësve gjatë tërë kohës
- Fletëkontrolli – shkathtësitë e plotësuara me shkrim

## ■ Udhëzuesi për nxënësin:

- Emri i nxënësit dhe data e zhvillimit të punës
- Numri dhe titulli i punës
- Qëllimi i punës ( shkruhet se çfarë hetoi, mati verifikoi,etj)
- Metodën.(nx. bënë përshkrim të procedurës së kryerjes puës)
- Të dhënat. (nx. bënë një pasqyrë të vrojttimeve, dhe matjeve duke i përfshirë të dhënëat nënjë tabelë)
- Analizën. ( nx. Paraqet llogaritjet e bëra , grafiqet dhe përgjigjet e pyetjeve duke bërë përmbledhjen e asaj që ka realizuar në punë )

# TABELA E VLERËSIMIT

Nxënësi \_\_\_\_\_ Klasa \_\_\_\_\_ Data \_\_\_\_\_

	Shkathtësia	Vlerësimi (2-5)
	Shakthtësia metodike	
	• Lexon përmbajtjen e punës	
	• Kupton qëllimin e punës	
	• Ndjek të gjitha udhëzimet e dhënë me shkrim ose me gojë	
	• Nuk improvizon pa leje	
	• Regjistron me saktësi të gjitha vrojtimet dhe të dhënat	
	• Aktivizon brenda grupit	
	• Arrin rezultatet e synuara	
	• Përgjigjet me saktësi pyetjeve të bazuara te të dhënat	
	• Bënë lidhjen e punës së labor. (punishtes) me materjalin e tekstit	
	...	
	...	

## Shkathtësitë e zbatimit

- Monton paisjet sipas instrukcionit
- Përdorë me saktësi veglat dhe instrumente

...

...

## Shkathtësitë e sigurisë në laborator (punishtë)

- Kupton dhe ndjek të gjitha rregullat e sigurisë
- Përdorë mjetet mbrojtëse sa herë që është e nevojshme
- Përdorë mjetet e ndieshme me shumë kujdesë
- Shërbehet me kujdesë me grupin për t`iu larguar rrezikut
- Nuk silet për kotë në laborator (punishtë)
- Mbanë rend dhe higjienë në vendin e kryerjes së praktikës

...

# TESTI

Lënda: Matematikë Nxënësi (..... Kujdes shifra jo emri)

Nr	Kërkesat	Rezultati	Vërejtje	Pikët
1.	Cili numër vie pas ... ?			2
2.	Çfarë ... ?			2
3.	Pse ... ?			1
4.	Krahaso ... ?			2
5.	Në cilin rast është ?			3
6.	Vlerëso se ... ?			2
7.	Analizo ... ?			2

8.						2
9.						2
10.						2

Pikët	0 - 8	9 - 12	13 -16	17-18	19-20	Nota
Nota	1	2	3	4	5	

Deshifrimi (pas kontrollimi)	Nënshkrimi i mësime dhënësit

# Procesi i ndërtimit të testit

1. Përcaktimi i qëllimit të testit
2. Planifikimi i përmbajtjes
3. Tabela e specifikave
4. Seleksionimi i llojit të kërkesave
5. Përpilimi i kërkesave
6. Formimi i formave ekuivalente të testit



# Dy karakteristikat e rëndësishme të testit:

- Besueshmëria;
  - Sa janë të qëndrueshme pikët e një testi nga një matje në tjetrën
- Vlerëshmëria;
  - A mat testi atë që ne kemi synuar ta masim

# Llojet e testit:

- **Formativ**

Vëzhgon progresin drejt qëllimeve brenda orës mësimore

- **Përmbledhës**

Vlerëson arritjet e gjithmbarshme të qëllimeve të lëndës

# Tabela e Specifikave

- Udhëzuesi për përpilimin e kërkesave
  - Përbëhet prej tri komponenteve:
    - Përmbajtja e lëndës
    - Objektivat
    - Numri i kërkesave

# Tabela e Specifikave

- Shembull:

Lënda: Matematikë:

Kategoria: Aritmetikë dhe algjebër

1. Numrat realë
2. Shprehjet shkronjore
3. Ekuacionet dhe inekuacionet
4. Përpjesëtimi
5. Funkzioni
6. Sistemi i ekuacioneve lineare

Lënda : Matematikë

Nënkategoria: Ekuacionet dhe inekuacionet

1. Ekuacionet e njëvlershme
2. Ekuacionet e fuqisë së parë me një ndryshore
3. Zbatimi i ekuacioneve të fuqisë së parë me një ndryshore
4. Zgjidhja e ekuacioneve me parametra- diskutimi
5. Inekuacionet e formës :  $ax * b$ .
6. Inekuacionet e formës:  $(ax+b) \cdot (cx+d) * 0$ .
7. Inekuacionet e formës:  $(ax+b) / (cx+d) * 0$ .
8. Zbatimi i inekuacioneve të fuqisë së parë  
[shenja (\*) zëvendësohet me:  $>$ ,  $<$ ,  $\geq$ ,  $\leq$ ]

# Matematikë: Aritmetika dhe algjebra

	Nivelet	e	nxënies
Përmbajtja	Njohje	Të kuptuar	Zbatim & Mendimi kritik
Numrat realë			
Shpreh. shkronj			
Ek. dhe inek			
Përpjesëtimi			
Funksioni			
Sistemi i eku. lineare			

## Çka duhet pasur në konsideratë:

- Gjatësia e testit;
- Pesha e dhënë secilës përmbajtje;
- Pesha e dhënë secilit nivel të dijës;
- Shpërndarja e kërkesave;

# Matematikë: Aritmetika dhe algjebra

	Nivelet	e	Nxënjes	
Përmbajtja	Njohje	Të kuptuar	Zbatim	
Numrat realë.	4	6	0	10
Shprehjet shkr.	2	4	2	8
Ek dhe inek.	0	6	4	10
Përpjesëtimi.	2	2	2	6
Funksioni.	2	2	4	8
Sistemi i eku lineare	2	2	4	8
<b>Gjithsej</b>	<b>12</b>	<b>22</b>	<b>16</b>	<b>50</b>



# Zgjedhja e llojit të kërkesave :

- Lloji i kërkesave

- Objektive

- e saktë/ e pasaktë
- me plotësim
- me përputhje
- me zgjidhje të shumëfishta

- Subjektive

- ushtrimet interpretuese
- ese

Faleminderit